



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr.60/2019**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Fejzullah Rexhepi kryesues, Rustem Thaçi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Florije Krasniqi, duke vendosur lidhur me apelin e Nazim Isufi, paraqitur ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shkak të refuzimit të aplikimit dhe mos përfshirjes në listën e votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 20.09.2019, mori këtë:

## **V E N D I M**

**HUDHET** e palejuar apeli i Nazim Isufi, paraqitur ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shkak të refuzimit të aplikimit dhe mos përfshirjes në listën e votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datën 06.10.2019

### **Arsyetim**

PZAP-i, me datë 20.09.2019, ka pranuar një apel nga Nazim Isufi, me të cilin pretendon Gjergj Isufi ka aplikuar me dt. 09.09.2019 dhe se i ka bashkangjitur dokumentet e kërkuara për regjistrim për aplikim jashtë vendit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe se i është refuzuar aplikacioni nga KQZ-ja dhe i njëjti kërkon që të përfshihet në listën votuese jashtë Kosovës.

Parashtruesi i apelit ka bashkangjitur si dëshmi kopjen e Pasaportës së tij.

Paneli, pas shqyrtimit të lejueshmërisë së apelit gjeti se:

## **Apeli është i palejuar**

Neni 119.1 i LZP-se përcakton se personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të paraqes një ankese pranë PZAP-it, mirëpo në rastin konkret apeli është i pa lejuar, sepse parashtruesi i apelit nuk ka poseduar autorizim për të paraqitur apel në emër të ndonjë personi tjetër.

Rregullës Nr.02/2015 të nenit 10.6 ku përcaktohet se: *Apelet duhet të dorëzohen me shkrim dhe të nënshkruara nga parashtruesi i apelit apo në emër të tij nga personi i autorizuar.*

Për arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 118 par.1 të LZP-së, dhe nenit 11 par.5 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 60/2019 më datën 20.09.2019.

**Kryesuesi i Panelit**  
**Fejzullah Rexhepi**



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa.